



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada – Government*

*Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -*  
*Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta - Ministry of Culture, Youth and Sports*

---

**RREGULLORE (MKRS) NR. 03/2023<sup>1</sup>**  
**MBI PUNËN E JURIVE VLERËSUERE DHE KOMISIONEVE PËR**  
**MBËSHTETJEN E PROJEKTEVE FILMIKE DHE AUDIO-VIZUALE NGA**  
**QKK**

---

<sup>1</sup> Rregullore (MKRS) Nr. 03/2023 mbi Punën e Jurive Vlerësuese dhe Komisioneve për Mbështetjen e Projekteve Filmike dhe Audio-Vizuale nga QKK, e nënshkruar nga Ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me datë 11.12.2023

## **Ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,**

Në mbështetje të nenit 16, paragrafit 2, të Ligjit Nr. 08/L-202 për Kinematografinë, (Gazeta Zyrtare Nr. 16 / 6 korrik 2023), nenit 11, paragrafit 1.5, të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, dhe nenit 38, paragrafit 6, të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare Nr. 15, 12.09.2011),

Nxjerr:

### **RREGULLORE (MKRS) NR. 03/2023 MBI PUNËN E JURIVE VLERËSUERE DHE KOMISIONEVE PËR MBËSHTETJEN E PROJEKTEVE FILMIKE DHE AUDIO-VIZUALE NGA QKK**

#### **Neni 1 Qëllimi**

Kjo rregullore përcakton rregullat për mënyrën e emërimit të jurive vlerësuese dhe komisioneve, procesin e punës, mënyrën e vendimmarrjes, të votimit, të përzgjedhjes dhe të aprovimit të projekteve filmike dhe audio-vizuale të subvencionuara nga Qendra Kinematografike e Kosovës (më tutje QKK).

#### **Neni 2 Fushëveprimi**

Dispozitat e kësaj rregulloreje përfshijnë mënyrën e ecurisë së realizimit të projekteve të mbështetura nga QKK-ja, detyrat, përgjegjësitë, përbërjen, kompensimin dhe mënyrën e zgjedhjes së jurisë vlerësuese dhe komisioneve.

#### **Neni 3 Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

- 1.1. **QKK** – nënkupton Qendrën Kinematografike të Kosovës;
- 1.2. **Drejtori** – nënkupton drejtorin e Qendrës Kinematografike të Kosovës;
- 1.3. **Komisioni i konkursit** – nënkupton komisionin administrativ që vlerëson dokumentacionin teknik të projekteve;

1.4. **Komisioni financiar** – nënkupton komisionin tekniko-financiar, i cili vlerëson buxhetet e projekteve;

1.5. **Juritë vlerësuese** – nënkupton juritë të cilat përzgjidhen për të bërë vlerësimin përmbajtjesor të projekteve të konkurseve për subvencionimin e projekteve filmike;

1.6. **Komisioni i kategorizimit** – nënkupton autoritetin shtetëror, në kuadër të QKK-së, që jep leje për shfaqje publike dhe kategorizim, sipas përshtatshmërisë për shfaqje publike të veprave filmike apo audio-vizuale të prodhuara në Republikën e Kosovës.

#### **Neni 4**

##### **Juritë vlerësuese dhe emërimi i tyre**

1. Juritë vlerësuese bëjnë vlerësimin përmbajtjesor të projekteve filmike dhe audio-vizuale të pranuar në konkurset publike të shpallura nga QKK-ja.
2. Juritë vlerësuese propozohen nga drejtori i Qendrës Kinematografike të Kosovës në bashkëpunim me Këshillin profesional. Anëtarët e jurive emërohen nga drejtori brenda 5 ditësh nga data e përfundimit të vlerësimit administrativ nga komisioni i konkurseve.

#### **Neni 5**

##### **Përbërja e jurive vlerësuese**

1. Juritë vlerësuese përbëhen nga pesë (5) anëtarë, personalitete të shquara nga fusha e kinematografisë: regjisorë, producentë, aktorë, skenaristë, montazherë, drejtorë fotografie, kritikë të filmit, kompozitorë, programerë të festivaleve, distributor, agjent të shitjes së filmave dhe kineastë e të tjerë, të cilët mund të jenë vendas dhe ndërkombëtarë.
2. Përbërja e jurive e vlerësuese publikohet në faqen zyrtare të QKK-së.

#### **Neni 6**

##### **Njoftimi i anëtarëve të jurisë vlerësuese lidhur me konfliktin e interesit**

1. Anëtarët e jurisë vlerësuese paraprakisht paralajmërohen për kufizimet, të cilat rrjedhin nga ligjet në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit, si dhe për emrat e aplikuesve dhe autorët pjesëmarrës në konkurs.
2. Në rast se ndonjëri prej anëtarëve të jurive mund të ketë konflikt të interesit, i njëjti largohet nga vlerësimi, diskutimi dhe kompenzimi nga kategoria, dhe zëvendësohet me anëtar të ri me vendim të drejtorit.

3. Nëse në një kategori përkatëse konstatohet se ka apo mund të ketë konflikt interesi ndërmjet anëtarëve të jurisë atëherë të njëjtit përjashtohen nga juria dhe duhet të zëvendësohen me anëtarë të rinj.

### **Neni 7** **Mbledhjet e jurive vlerësuese**

1. Mbledhjen e jurisë vlerësuese e thërret drejtori i QKK-së.
2. Drejtori njofton anëtarët e jurisë vlerësuese për disponueshmërinë e mjeteve financiare për konkurs.

### **Neni 8** **Kompensimi i jurive vlerësuese**

1. Kompensimi i anëtarëve të jurive vlerësuese vlen për leximin e skenarëve dhe dokumentacionit përcjellës, dhe pjesëmarrjen në takime.
2. Kompensimi i anëtarëve të jurive vlerësuese për filma të metrazhit të gjatë dhe koproduksion minor është në shumën 120.00€.
3. Kompensimi i anëtarëve të jurive vlerësuese për filma të metrazhit të shkurtër artistikë, të animuar dhe dokumentar është në shumën 70.00€.
4. Kompensimi i anëtarëve të jurive vlerësuese për film të metrazhit të gjatë dokumentar është në shumën 80.00€.
5. Kompensimi i anëtarëve të jurive vlerësuese për zhvillim skenari për film të metrazhit të gjatë, për zhvillim të projektit për film të metrazhit të gjatë, postproduksion për film të metrazhit të gjatë, është në shumën 40.00€;
6. Kryesuesi i jurisë vlerësuese i udhëheqë mbledhjet e jurisë.

### **Neni 9** **Dokumentimi**

1. Për çdo mbledhje të jurisë mbahet procesverbal.
2. Për secilën juri vlerësuese caktohet një zyrtar për hartimin e procesverbaleve.

**Neni 10**  
**Detyrat e jurisë vlerësuese të QKK-së**

1. Juria vlerësuese përzgjedh projektet filmike fituese dhe sugjeron ndarjen e buxheteve bazuar në dosjen e projektit filmik.
2. Kryesuesi i jurisë vlerësuese ka të drejtën e thirrjes së takimeve të përbashkëta me komisionin financiar gjatë kohës së vlerësimit të projekteve.

**Neni 11**  
**Mënyra e vlerësimit**

1. Juria vlerësuese vlerëson dhe rendit projektet me pikë.
2. Numri maksimal i pikëve përcaktohet nga numri i projekteve pjesëmarrëse, p.sh. nëse janë pjesëmarrëse 30 projekte për vlerësim atëherë vlerësimi maksimal është 30 pikë për vendin e parë, 29 pikë për vendin e dytë, 28 pikë për vendin e tretë, 27 pikë për vendin e katërt, e kështu me radhë deri te projekti i fundit.
3. Pikët e secilit anëtar mblidhen dhe japin totalin e pikëve të fituara nga projekti përkatës.
4. Në rast nevoje, juria vlerësuese mund ta ftojë për konsultim më të hollësishëm listën e ngushtë të projekteve me më së shumti pikë.
5. Anëtarët e jurive vlerësuese paraprisht shërbejnë me forma zyrtare të vlerësimit.

**Neni 12**  
**Procedura pas vlerësimit të jurisë**

1. Pasi të ketë bërë vlerësimin dhe renditjen e projekteve, juria vlerësuese takohet me komisionin financiar për të përfunduar listën e projekteve fituese dhe shumat përkatëse.
2. Juria vlerësuese dhe komisioni financiar ia paraqet drejtorit vendimet për projektet e përzgjedhura së bashku me shumat e përcaktuara të subvencionimit.
3. Pas pranimit të vendimeve, drejtori i QKK-së lidhë kontratë me secilin përfitues.

**Neni 13**  
**Komisioni financiar**

1. Komisioni financiar përbëhet prej 3 anëtarëve të cilët emërohen nga drejtori i QKK-së.

2. Komisioni financiar komunikon me jurinë vlerësuese, ashtu siç përcaktohet në nenin 11 të kësaj rregulloreje.
3. Komisioni financiar caktohet brenda 5 ditësh nga data e përfundimit të vlerësimit artistik nga juria vlerësuese.
4. Komisioni financiar ka përgjegjësinë të shqyrtojë dhe të vlerësojë buxhetin e projekteve të përzgjedhura nëse i njëjti është hartuar në përputhje me rregullat dhe standardet e çmimeve të tregut aktual në industrinë e filmit, duke pasur për bazë dokumentin i cili parasheh minimumin dhe maksimumin e mbështetjes financiare të një pozicioni të caktuar në film (çmimorja). Ky dokument përditësohet në bazë të vlerësimit të QKK.
5. Komisioni financiar i lexon projektet e përzgjedhura nga juria vlerësuese dhe së bashku me jurinë vlerësuese cakton shumën e subvencionimit.
6. Anëtarët e Komisionit financiar së bashku me drejtorin e QKK-së, pas marrjes së vendimit për subvencionim përcaktojnë shumën e kështit të dytë dhe të tretë të subvencionimit në konsultim me palët fituese, përjashtimisht projekteve të cilat janë të parapara të paguhen me një kësht.
7. Pagesat/honoraret për anëtarët e komisionit financiar është si vijon:
  - 7.1. Kompensimi i anëtarëve të komisionit financiar për filma të metrazhit të gjatë artistikë, koproduksion minor është në shumën 120.00€;
  - 7.2. Kompensimi i anëtarëve të komisionit financiar për filma të metrazhit të shkurtër artistikë, dokumentarë dhe të animuar është në shumën 70.00€;
  - 7.3. Kompensimi i anëtarëve të komisionit financiar për film të metrazhit të gjatë dokumentar është në shumën 80.00€;
  - 7.4. Kompensimi i anëtarëve të komisionit financiar për zhvillim skenari, për zhvillim projekti dhe postproduksion për film të metrazhit të gjatë është në shumën 40.00 €.

## **Neni 14**

### **Ruajtja e dokumentacionit të projekteve**

1. Juria vlerësuese ia dorëzon Arkivit të Qendrës Kinematografike listën e plotë të projekteve të shqyrtuara dhe të poentuara.
2. QKK-ja ruan të gjithë dokumentacionin e projekteve.
3. QKK-ja ruan dhe arkivon procesverbalet e mbledhjeve të jurive vlerësuese.

**Neni 15**  
**Komisioni i Kategorizimit**

1.Puna, kompetencat dhe përbërja e komisionit të kategorizimit rregullohet si në nenin 17 të Ligjit Nr. 08/L-202 për Kinematografinë.

2. Anëtarët e komisionit të kategorizimit kompenzohen për çdo minutë të materialit të cilin e vizionojnë:

2.1. Secili minut i vizionuar i filmit kompenzohet me 1.50 €.

**Neni 16**  
**Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja (MKRS) Nr. 08/2016 për Punën e Jurisë Vlerësuese për Projektet Filmike që Subvencionohen nga Qendra Kinematografike e Kosovës dhe çdo akt tjetër nënligjor që bie ndesh me këtë rregullore.

**Neni 17**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministëri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Hajrulla Çeku

\_\_\_\_\_  
Ministër i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Datë: 11.12.2023